



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË

Nr. 1862 prot.

04.10.2024

P/V E N D I M

Nr. 1 , datë 04.10.2024

**PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE
LIGJORE PËR SHITJEN ME ANKAND TË AKSIONEVE TË KLUBIT TË
FUTBOLLIT "FK TËRBUNI" SHA ME NIPT L19704301F NË MASEN
100%**

Mbeshtetur në nenin 113, pika 2 të ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar, nenit 8, pika 2, neni 9 pika 1, nën-pika 1.1 shkronja "b", nën-pika 1.2, shkronja "a", nenit 54 gërma "e" të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Per Vetëqeverisje Vendore" i ndryshuar, ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tragtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar, Ligjin nr.105/2020 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.79/2017 "Për Sportin", Ligjit nr.9874, dt.14.02.2008 "Për ankandin publik" i ndryshuar, themeluar si Shoqeri Aksioner me date 14.10.2011, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak :

Vendosi:

- I. Dhënie e pëlqimit për fillimin e procedurave ligjore për shitjen me Ankand në masen 100% të aksioneve që Bashkia Pukë zotëron si aksionere e vetme në Shoqërine Klub Futboll "Tërbuni" sh.a
- II. Të merren masat që të përcaktohet sipas procedurave ligjore ekspertët përkatës për hartimin e raportit të vlersimit të aksioneve dhe përcaktimin e vlerës minimale të shitjes.
- III. Forma e shitjes së aksioneve që zotërohen nga Bashkia Puke në Shoqërinë Klub Futboll Tërbuni të bëhet nepërmjet procedurës konkurruese, Procedure e Hapur Standart e Ankandit.
- IV. Për ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e Bashkisë Pukë.
- V. Ky vendim hyn në fuqi brenda 10 ditësh pas shpalljes
- VI. U shpall me datë _____

Hartues

Endrit KRAJA

MIRATON

KRYETARI

RROK DODAJ



JURISTI
Aida SINANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
Sektori Juridik

Date 04.10.2024

Nr 1862/1 Prot

RELACION
PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE LIGJORE
PËR SHITJEN ME ANKAND TË AKSIONEVE TË KLUBIT TË
FUTBOLLIT "FK TËRBUNI" SHA ME NIPT L19704301F NË MASEN 100%

DREJTUAR : KËSHILLIT BASHKIAK PUKË

Mbeshtetur në nenin 113, pika 2 të ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar, nenit 8, pika 2, neni 9 pika 1, nën pika 1.1 shkronja "b", nën pika 1.2, shkronja "a", nenit 54 gërma "e" të ligjit nr.139/2015, date 17.12.2015 "Per Vetëqeverisje Vendore" i ndryshuar, ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tragtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar, Ligjin nr.79/2017 date 27.04.2017 "Për Sportin" i ndryshuar, Ligjit nr.9874, dt.14.02.2008 "Për ankandin publik" i ndryshuar, themeluar si Shoqeri Aksioner me date 14.10.2011.

Kjo kërkesë vjen si rezultat i përcaktimeve ligjore për detyrimin e pushteti vendor për privatizimin e klubeve sportive të shoqëruar dhe me kërkesat nga Federata Shqiptare e Futbollit dhe të KLSH. Me anë të këtij projekt-vendimi kërkojmë dhënie të pëlqimit për fillimin e procedurave ligjore për shitjen me Ankand në masen 100% të aksioneve që Bashkia Pukë zotëron si aksionere të vetme në Shoqërinë Klub Futboll "Tërbuni" sh.a

Po ashtu njëkohësisht Bashkia Puke të marra masa në vijim që të përcaktohet sipas procedurave ligjore ekspertët përkatës për hartimin e raportit të vlersimit të aksioneve dhe përcaktimin e vlerës minimale të shitjes e cila do të shërbejë në të ardhmen pas shprehjes së Këshillit Bashkiak në lidhje me fillimin e procedurave ligjore për shitjen e Ankandit.

Procedurat ligjore në vijim nëse jepet pëlqimi do jenë sipas përcaktimeve ligjore me anë të Ankandit Publik të Hapur ku Bashkia Puke do i drejtohet Këshillit Bashkiak për miratimin e Dokumentave të Ankandit, Raportit të vlersimit nga ekspertët përkatës ku do përfshihet edhe vlera minimale e aksioneve. Po ashtu e gjithë procedura do të zhvillohet në bashkëpunim dhe me Federatën Shqiptare të Futbollit duke marrë eksperiencën nga procedurat e ngjashme .

Hartues

Endrit Kraja